

12.07.2010

STATISTIKAT JANAR-QERSHOR 2010

NË 6 MUAJ MË SHUMË UDHËTARË, AUTOMJETE DHE MALLRA ME TRAGETE

Në periudhën janar-qershor të vitit 2010 tragetet e linjave detare nga Durrësi në Bari, Ankona dhe Trieste (Itali) e anasjelltas kanë transportuar më shumë udhëtarë, automjete dhe mallra, krahasuar me të njejtën periudhë të vitit 2009.

Statistikat e përpunuara nga sektori përkatës pranw Drejtorisw sw Autoritetit Portual dëshmojnë se 258.053 udhëtarë shqiptarë dhe të huaj me 58.677 autovetura gjithsej, ose përkatësisht 4 dhe 10 përqind më shumë se sa e njehta periudhë e vitit 2009 kanë shfrytëzuar gjatë këtij 6-mujori tragetet që nisen dhe mbërrijnë në portin mw tw madh tw vendit.

Nga Durrësi në drejtim të porteve të Italisë janë nisur me tragete 142.856 udhëtarë me 27.577 autovetura, ndërsa 115.897 udhëtarë dhe 31.100 autovetura të tjera janë regjistruar në hyrje. Shifrat janë përkatësisht 4 dhe 5 përqind më të larta se sa 6-mujori i parë i vitit 2009.

Numri i shqiptarëve që preferojnë tragetet ka mbetur thuajse në të njejtat kuota, ndërsa ka një rritje të shtetasve të huaj me tragete prej 8 dhe 13 përqind në hyrje dhe në dalje të portit të Durrësit. Brenda 6 muajve tragetet janë shfrytëzuar nga më shumë se 80 mijë shtetas të huaj dhe në këtë shifër futen edhe qytetarët nga Kosova.

Tragetet kanë transportuar gjithashtu rreth 34.149 kamjonë dhe trajlera me 359.858 ton mallra gjithsej, duke shënuar një rritje prej 44.843 ton ose 14 përqind krahasuar me të njejtën periudhë të vitit 2009.

15 tragete dhe një katamaran që punojnë për llogari të kompanive të ndryshme kanë kryer 722 lundrime gjatë 6-mujorit të parë të këtij viti.



